



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ADMINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Nr. 118/1 Prot.

Tiranë, më 21.01 . 2023

Lënda : Për ndjekje.

DREJTORISË RAJONALE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR _____

Pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, është depozituar shkresa Nr. 212/4 prot., datë 16.01.2023 “Për fillimin e bisedimeve për kontratën kolektive” e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, ku është kërkuar nga ana juaj njoftimi i Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar që kenë në juridiksion dhe marrja e masave për publikimin e njoftimit, në këndet e informimit të institucionit dhe në faqet zyrtare për të gjitha strukturat e arsimit parauniversitar, si dhe njoftimi i mësuesit për fillimin e bisedimeve për kontratën kolektive.

Për sa më sipër, kërkojmë nga ana juaj, marrjen e masave për njoftimin e Zyrave Vendore të Arsimit Parauniversitar dhe publikimin e njoftimit si dhe njoftimi i mësuesit për fillimin e bisedimeve për kontratën kolektive.

Bashkëlidhur shkresa e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Rezarta Atja





REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE PËR ARSIMIN DHE SPORTIN
DREJTORIA E PROGRAMIMIT, STANDARDIZIMIT DHE HARMONIZIMIT
TË KUADRIT RREGULLATOR

Nr. 212/24 Prot.

Tiranë, më 16.1.2023

Lënda: Mbi fillimin e bisedimeve për kontratën kolektive

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Tiranë

DREJTORISË RAJONALE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR, DURRËS

Adresa: Lagja Nr. 12, Rruga "Mujo Ulqinaku", te Shkolla "Marie Kaçulini", Durrës

DREJTORISË RAJONALE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR, FIER

Adresa: Lagja "Kastriot", Rruga "Leon Rei", Fier

DREJTORISË RAJONALE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR, KORÇË

Adresa: Rruga "Dhimitër Denasi", Korçë

DREJTORISË RAJONALE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR, LEZHË

Adresa: Sheshi "Gjergj Kastrioti", Lezhë

Në vijim të përfundimit të afatit të kontratës kolektive nr. 6145 datë 5.6.2018 dhe në zbatim të nenit 163 të Kodit të Punës Ministria e Arsimit dhe Sportit ka shpallur njoftimin nr. 212/2 prot., datë 13.1.2023 për fillimit të bisedimeve për lidhjen e kontratës kolektive të punës për profesionin e rregulluar të mësuesit, i cili përmban dokumentacionin që do të paraqesin organizatat përfaqësuese sindikale që përcaktohen në pikën 3 të nenit 163 të Kodit të Punës.

Në këtë kuadër, Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar të përcjellin këtë njoftim te Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar, si dhe të marrin masa për publikimin e njoftimit të sipërcituar, bashkëlidhur kësaj shkrese, në këndet e informacionit të institucionit dhe në faqet zyrtare, për të gjitha strukturat e arsimit parauniversitar, si dhe të njoftohen e mësuesit për fillimin e bisedimeve për kontratën e re kolektive.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Erzen Tola



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

Nr. 212/prot.
12

Tiranë, më 11/1/2023

NJOFTIM

**MBI FILLIMIN E BISEDIMEVE PËR LIDHJEN E KONTRATËS KOLEKTIVE TË
PUNËS NË FUSHËN E MËSUESISË**

Në zbatim të kreut XV të Kodit të Punës dhe kërkesës së disa organizatave përfaqësuese sindikale, Ministria e Arsimit dhe Sportit njofton fillimin e bisedimeve për lidhjen e kontratës kolektive të punës për profesionin e rregulluar të mësuesit.

Të gjitha organizatat përfaqësuese sindikale në fushën e mësuesisë ftohen të shprehin interesin dhe të paraqesin dokumentacionin e nevojshëm brenda datës 31 Janar 2023 pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Dokumentacioni duhet të përmbajë dokumentet e parashikuara në pikën 3 të nenit 163 të Kodit të Punës, si më poshtë:

- Kërkesë për fillimin e bisedimeve;
- Vendimin e gjykatës dhe statutin e organizatës;
- Dokumentacionin me treguesit e nevojshëm për përfaqësueshmërinë e anëtarësisë sindikale.

Ky njoftim të publikohet në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar, Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar dhe Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar. Po ashtu, ky njoftim botohet në buletinin e njoftimeve zyrtare në Qendrën e Botimeve Zyrtare dhe Buletinin e Njoftimeve Publike të Agjencisë së Prokurimit Publik.

Duke ju falënderuar,

MINISTËR

EVIS KUSHI

